

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO - PD ankimon në Kushtetuese VKM-në e Ramës, i hapi rrugë ndërtimeve të projekteve
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919093/pd-ankimon-ne-kushtetuese-vkm-ne-e-rames-qe-i-hapi-rruge-ndertimeve-te-projekteve-albanian-files-ne-pishporo-narte/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 10:10:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 09:52:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0cc6885324d524a79fba7df1e885c55d7144e15ff1a64313e86f7cc1f99d4a1a
TEKSTI	9783cc2c2241828997c58bd2f6ec944f1b0e322bac96e9e2a4866d267615e785
PAMJA	beb14ba9bc67542a30026cbe74d0bd2e2a3539fedc357dec1ba074a22cd75ada

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fcc45c7845468525b194531a0f25dbe700a4216131f4f1ee4f38c23d3b04fe2c
E MËPARSHMJA	460f48b13e6500ce43f36d4371741f384be86d3e8e56724c520cc6251f98507f
RRËNJA MERKLE	9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fcc45c7845468525b194531a0f25dbe700a4216131f4f1ee4f38c23d3b04fe2c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



NDRIÇIM KULLA

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve



ENVER BYTYÇI

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më

Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë

Akuzat për shefen e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin

Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës

PD ankimon në Kushtetuese VKM-në e Ramës, i hapi rrugë ndërtimeve të projekteve 'Albanian Files' në Pishporo-Nartë

11:52, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



PD ka ankimuar në Gjykatën Kushtetuese VKM e kryeministrit Rama e cila i hap rrugën planeve ndërtimore të qeverisë me projekte të botuara në 'Albanian Files', në zonën e Pishporo- Nartë ku përfshihet dhe zona e Zvërnecit.

Kërkesa u dorëzua sot në Gjykatë Kushtetuese nga Ina Zhupa, deputetja e PD-së, njëkohësisht kryetarja e Komisionit të Kryetares së Komisionit për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën dhe avokatin përfaqësuesin ligjor të PD-së, Marash Logu.



"Se si ulet mbrojtja e Pishporo-Nartë. Ju kujtoj që Pishporo-Nartë është edhe Zvërneci. Nga kategoria e katërt, një rezervat natyror i menaxhuar, kalohet në kategorinë e pestë, në një peizazh të mbrojtur.

Më pas, nga kategoria e pestë – peizazhi i mbrojtur që i ulet 5551 hektarë që i kishin më përpara dhe ja zbritën kur e bënë peizazh i mbrojtur.

Më pas, sipas ligjit të kohës, para se të ndryshonte ligji në 21/ 2024, edhe peizazhi i mbrojtur kishte zonim. Që do të thotë kishte një zonë qendrore në të cilën ti nuk mund të ndërtoje dhe të bëje asgjë, dhe kishte dhe nën-zona të tjera. Dhe 43% e peizazhit të mbrojtur Pishporo Nartë ishte zonë qendrore që ti nuk mund të ndërhyje dhe të bëje asgjë.

Me ligjin e ri dhe me ndryshimin e kësaj VKM-je (Vendim i Këshillit të Ministrave), janë hequr edhe nën-zonat. Pra, praktikisht me këtë VKM, jo vetëm që kalojnë nga kategoria e katërt në kategorinë e pestë, por ju hoqën edhe nën-zonat . Që do të thotë se kudo në Pishporo Nartë ti mund të ndërtoesh, duke cenuar drejtpërdrejt një zonë të mbrojtur, një herë me ligj dhe më pas duke e pasuar me VKM.

Duke qenë se VKM-ja është një provë e patjetërsueshme që e ul sipërfaqen, e ul kategorinë, që nuk ka më zonim për këtë zonë të mbrojtur dhe që e cenon drejtpërdrejt – dhe kjo i hapi rrugë në fakt planeve ndërtimore të Edi Ramës me projekte të botuara në librin

"Albanian Files" pikërisht në zonë të mbrojtur – ne gjykojmë që të vinim dhe të çonim këtë VKM në Gjykatën Kushtetuese. Për për t'ia lënë topin Gjykatës Kushtetuese se sa do t'i përgjigjet Gjykata Kushtetuese Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, standardeve të Bashkimit Europian. Sepse sot e ka kërkuar dhe e ka thënë Bashkimi Europian që është në kundërshtim me MSA e standardet.

Dhe sa i përgjigjet qytetarëve të Republikës së Shqipërisë që kanë ditë që protestojnë dhe kërkojnë që Gjykata Kushtetuese t'i përgjigjet atyre, dhe jo të bëhet një institucion që nuk i shërben askujt përveçse interesave të Edi Ramës" tha Zhupa.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Rama të dorëhiqet'/ Balliu: Hetimi për Hysenin e Agasin nuk mund të jetë serioz sa kohë ai është kryeministër



Zyrtare/ Klodiana Spahiu anulon tenderin 50 milionë euro të dializës



Noka: Shteti ka vdekur. Shefin e komisaritit e marrin me shpulla në rrugë

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



Forcat suedeze dhe finlandeze zbulojnë avionët ushtarakë rusë mbi Gjirin e Finlandës



Ambasada amerikane: Mezi presim të punojmë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri të Kosovës



'Sadushi i partisë' pranon të ulet në tryezë me Ramën për pagat: Por duhet të shprehet edhe Kushtetuesja



Gazeta amerikane: Ambasadori Wendt shkon në Shqipëri në kohën kur vendi është përfshirë nga protestat



Territorialja/ Intelktualët kundër shkrirjes së Bashkisë Patos, letër drejtuar Kuvendit



'Fonde IPARD? Deti i BE-së nuk u bë kos'/ Sharka: Me këtë qeveri e këto skandale, s'do kemi më financime



Vangjeli: 'TIMAK Defence' fatura del para procedurës, kontrata më pas, thesari pagoi 8.6 mln lekë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do të gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.